

FTESË PËR OFERTË

Përmet, 28.10.2025

Objekti: Ekspert për pjesëmarrjen Rinore dhe Planifikimin Strategjik

Autoriteti kontraktues: Shoqata Multifunksionale për Kulturë, Edukim dhe Zhvillim

Adresa: Rruga “18 Shtatori”, Pallati 6-Katësh në krah të Gjykatës, Apartamenti 11, Gjirokastrë,

E-mail: shoqata.mkezh@hotmail.com

Informacion i përgjithshëm

Organizata MKEZH po implemeton projektin “Të rinj që sjellin ndryshimin në Përmet” në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor – ReLOaD2 financuar nga Bashkia Përmet.

Qëllimi i projektit është: **Të kontribuojë në fuqizimin e të rinjve të Bashkisë Përmet** për të marrë pjesë aktive në proceset vendimmarrëse, për të kontribuar në zhvillimin e politikave lokale rinore dhe për të nxitur ndjenjën e përgjegjësisë qytetare përmes kreativitetit, inovacionit dhe bashkëpunimit komunitar.

Ky projekt do të zbatohet në Përmet dhe target grupi janë të rinjtë e qytetit të Përmetit.

Detyrat e ekspertit

Shoqata MKEZH në kuadër të implementimit të projektit me titull “Të rinj që sjellin ndryshimin në Përmet” shpreh interesin për kontraktimin e shërbimit Ekspert të jashtëm që do të lehtësojë procesin e konsultimeve me Këshillin Rinor dhe fuqizimin e tij në proceset vendimmarrëse si dhe do të përgatisë dokumentin përfundimtar të Planit Vendor të Rinisë.

Eksperti do të ketë rolin kryesor në:

- Zhvillimin e një procesi gjithëpërfshirës konsultimi me të rinjtë dhe strukturat përkatëse;
- Fuqizimin e rolit të Këshillit Rinor në proceset vendimmarrëse lokale;
- Hartimin e dokumentit të Planit Vendor të Rinisë që reflekton nevojat dhe prioritetet e të rinjve.
- Organizimin dhe lehtësimin e 12 takimeve gjatë periudhës nëntor–dhjetor 2025, që përfshijnë:
 - Takime me Këshillin Rinor të Bashkisë Përmet;
 - Takime konsultative me të rinj të komunitetit, organizata rinore, shkolla, aktorë lokalë etj;
- Fuqizimin e Këshillit Rinor përmes sesioneve informuese mbi:
 - Rolin dhe funksionimin e tij si strukturë pjesëmarrëse;
 - Angazhimin në proceset vendimmarrëse dhe bashkëpunimin me njësinë vendore;

- Finalizimin e dokumentit pas integritetit të komenteve nga Bashkia dhe Këshilli Rinor;
- Përgatitjen e një raporti përfundimtar mbi procesin dhe rekomandimet për zbatimin e Planit.

Kohëzgjatja dhe vendndodhja

- Periudha: Nëntor – Dhjetor 2025
- Numri i takimeve: 12
- Vendndodhja: Bashkia Përmet

Kualifikimet e kërkuara

- Diplomë universitare në shkencë sociale, zhvillim komunitar, politikë publike ose fusha të ngjashme;
- Minimum 3 vite përvojë pune në fusha që lidhen me rininë, zhvillimin lokal apo politikëbërjen;
- Eksperiencë në lehtësimin e takimeve dhe proceseve pjesëmarrëse me të rinjtë;
- Njohuri mbi funksionimin e qeverisjes vendore dhe strukturave rinore;
- Aftësi shumë të mira komunikuese dhe analitike;
- Aftësi për të hartuar dokumente strategjike dhe raporte profesionale.

Dokumentacioni i detyrueshëm

- ✓ CV e detajuar, ku të ketë edhe kontaktet për referenca pune të ngjashme.
- ✓ Kopje e diplomës
- ✓ Letër motivimi



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



Empowered lives.
Resilient nations.

Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Kushtet e ofertës

- Oferta duhet të shprehet në Lek.
 - Çmimi i ofertës duhet të përfshijë të gjitha kostot që lidhen me realizimin e shërbimit si dhe detyrimet tatimore kundrejt shtetit.
 - Çmimi i ofertës përbën shifrën totale dhe mbetet i pandryshuar gjatë realizimit të shërbimit.
 - Pagesa për shërbimin do të realizohet vetëm nëpërmjet transfertës bankare.
- Vlerësimi i ofertave do të mbështetet duke pasur si referencë kryesore përmbushjen e

- ✓ Kualifikimeve të kërkuara dhe çmimin më të ulët.

Personat e interesuar duhet të dërgojnë dokumentacionin në adresën **shoqata.mkezh@hotmail.com**, ose në zarf të mbyllur me postë, **deri në datën 07.11.2025**, në adresën: Rruga “18 Shtatori”, Pallati 6-Katësh në krah të Gjykatës, Apartamenti 11, Gjirokastrë.

Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi i kandidaturave do të mbështetet duke pasur si referencë kualifikimet e kërkuara më sipër.

Mënyra e pagesës

Pagesat do të kryhen me transfertë bankare pas marrjes së shërbimit.



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



Empowered lives.
Resilient nations.

Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).



OFERTË

EMRI OFERTUESIT: _____

ADRESA: _____

Cmimi i ofruar për realizimin e shërbimit është:

Nr	Përshkrimi i shërbimit	Njësia	Sasia	Cmimi për njësi në LEK	Cmimi total në LEK
1	Ekspert për pjesëmarrjen Rinore dhe Planifikimin Strategjik	takime	12		

OFERTUESI
(emër, mbiemër, firmë)

Data ____/____/2025